



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 185

dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|-------|
| Udhëzim i KM nr. 5, datë 12.12.2012 | Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbartuesi gjyqësor..... | 10869 |
| Udhëzim i MBUMK nr. 15, datë 13.12. 2012 | Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin..... | 10873 |
| Udhëzim i MBUMK nr. 18, datë 27.12.2012 | Për sasinë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në paketime origjinale që mund të importohet për përdorim vetjak..... | 10877 |
| Urdhër i MBUMK nr. 348, datë 14.12.2012 | Për miratimin e programeve mbikëqyrëse, çrrënjësore dhe statusit “I lirë nga sëmundjet”, të zonave ku rriten kafshët ujore dhe ndarjeve të tyre | 10882 |
| Urdhër i MBUMK nr. 355, datë 18.12.2012 | Për kriteret e miratimit të laboratorit të referencës..... | 10901 |

UDHËZIM
Nr. 5, datë 12.12.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR ZHVILLIMIN E ANKANDIT
NGA PËRMBARUESI GJYQËSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të katërt të nenit 573 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbartuesi gjyqësor për shitjen e sendeve të debitorit, të cilat janë sekuestruar, për të garantuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë, si dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedurën e ankandit.

2. Përmbartuesi gjyqësor, gjatë zhvillimit të procedurës së ankandit, udhëhiqet nga parimet:

- a) e ligjshmërisë;
- b) e garantimit të të drejtave të kreditorit, nëpërmjet ekzekutimit të vendimit gjyqësor të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë;
- c) e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit;
- ç) e transparencës;
- d) e garantimit të procesit të rregullt ligjor.

3. Përmbartuesi gjyqësor është përgjegjës për realizimin e ankandit në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të këtyre rregullave.

Përmbartuesi gjyqësor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të ankandit, në mënyrë të tillë që të lejojë kontrollin nga strukturat përgjegjëse të zbatimit të ligjit. Këto procesverbale dhe dokumente janë pjesë e dosjes përmbartimore.

4. Përmbartuesi gjyqësor duhet të shmangë kërkesat apo procedurat që përbëjnë diskriminim ndaj ose ndërmjet kandidatëve blerës apo ndaj kategorive të tyre.

5. Përmbartuesi gjyqësor refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrjen në procedurën e ankandit, nëse:

a) ofertuesi apo kandidati blerës i jep ose premtun t’i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim apo procedurë që ndërmerr përmbartuesi gjyqësor për procedurën e ankandit;

b) ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit. Refuzimi dhe arsytet për një veprim të tillë pasqyrohen në procesverbalet e procedurave të ankandit dhe i komunikohen menjëherë e zyrtarisht, kandidatit ose ofertuesit në fjalë. Në këtë rast, përmbartuesi gjyqësor, kur aktet apo veprimet në fjalë përbëjnë vepër penale, bën kallëzim penal, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

6. I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në këtë udhëzim bëhen ose dokumentohen me shkrim dhe janë pjesë e dosjes përmbartimore.

Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhet në mënyrë të tillë, që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

7. Përmbartuesi gjyqësor vendos në dispozicion të çdo personi të interesuar, me kërkesë të tij, pasi është përcaktuar oferta fituese apo pasi procedurat e ankandit kanë përfunduar pa përcaktuar një fitues, informacionin e administruar për çdo ankand, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Në çdo rast, përmbartuesi gjyqësor vë në dijeni menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e vendimit:



- a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në ankand;
- b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;
- c) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për karakteristikat dhe përparësitë e ofertës së përzgjedhur.

Përrjashtim nga e drejta për informim bëhet vetëm në rast se dhënia e informacionin vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale ose cenon interesin publik apo interesat ligjore dhe ekonomike të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë.

Në çdo rast emrat dhe numri i kandidatëve, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të ankandit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen konfidenciale. Përmbaruesi gjyqësor nuk i bën publike informacionet e marra nga kandidatët blerës ose ofertuesit, të etiketuara si konfidenciale, ku veçanërisht përfshihet informacioni për aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

8. Afatet kohore në këtë udhëzim jepen në ditë pune, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe.

II. PËRGATITJA E ANKANDIT

1. Pas vënies së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor i kërkon kreditorit dhe debitorit që, me marrëveshje, të përcaktojnë vlerën e sendit.

Nëse brenda një jave nga njoftimi, kreditori dhe debitori nuk arrijnë marrëveshjen, përmbaruesi gjyqësor, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përcakton me vendim vlerën e sendit, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar, dhe vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestros mbi të.

Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor njofton kreditorin dhe debitorin për çmimin e caktuar, duke e lajmëruar këtë të fundit që në rast se brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi ai nuk përmbush detyrimin, sendi i sekuestruar do të shitet në ankand.

2. Të nesërmen e kalimit të afatit 10-ditor nga njoftimi për përmbushjen e detyrimit, përmbaruesi gjyqësor nxjerr vendimin për shitjen e sendit në ankand, duke bërë edhe shpalljen për këtë qëllim, e cila afishohet në pjesë të dukshme dhe lehtësisht të aksesueshme për publikun e gjerë në:

- a) zyrën e përmbaruesit gjyqësor;
- b) vendin ku ndodhet sendi;
- c) gjykatën që ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit;
- ç) komunë, bashki apo njësi bashkiake, sipas rastit;
- d) një vend apo vende të tjera publike, që përmbaruesi gjyqësor i çmon të përshtatshme për të siguruar nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjen e blerësve në procedurën e ankandit.

Shpallja e shitjes në ankand u njoftohet edhe kreditorëve që kanë hipotekë mbi sendin.

3. Përmbaruesi gjyqësor, në shpalljen për shitjen në ankand, përcakton domosdoshmërisht:

- a) gjenealitetet e pronarit të sendit, ku përfshihen emri, atësia dhe mbiemri;
- b) specifikimin nëse për sendin është vënë hipotekë dhe për çfarë shume të hollash;
- c) çmimin e sendit me të cilin do të fillojë shitja;
- ç) vendin ku do të realizohet ankandi;
- d) ditën kur do të përfundojë shitja në ankand.

4. Përmbaruesi gjyqësor, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e objektit të ankandit dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar, minimalisht, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga shpallja e ankandit.

5. Shpallja për shitjen në ankand shoqërohet edhe me informacionin për:

- a) sendin që do të shitet;
- b) vendin, adresën dhe afatin e fundit kohor, për paraqitjen e ofertave dhe dorëzimin e dokumenteve të ankandit;
- c) gjenealitetet e përmbaruesit gjyqësor, që është përgjegjës për realizimin e ankandit;
- ç) gjuhën/gjuhët, në të cilën/at duhet të hartohen ofertat;

d) mënyrën dhe kushtet për marrjen e dokumenteve të ankandit;

dh) orën dhe datën e hapjes së ofertave, si dhe pjesëmarrjen në hapjen e tyre.

Informacioni për sendin që do të shitet në ankand përgatitet nga përmbartuesi gjyqësor dhe përmban karakteristikat e sendit, duke e përshkruar atë sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, për të krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Informacioni për sendin që do të shitet në ankand:

i) duhet t'i referohet aktit të pronësisë mbi sendin apo aktit ligjor të disponibilitetit të tij;

ii) duhet të përshkruajë sendin në përputhje me standardet e vlerësimit sipas sasisë, çmimit për njësi dhe çmimit në total, metodologjisë së përdorur për vlerësimin e sendit të shitjes;

iii) duhet të shoqërohet, kur është e nevojshme, me genplane, planimetri të objektit, vizatime, modele, makete, mostra, fotografi, analiza kimike dhe dokumente të ngjashme;

iv) duhet të përshkruajë gjendjen funksionale të sendit nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.

Informacioni duhet të hartohet në një mënyrë të përshtatshme që u lejon kandidatëve të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e ankandit.

6. Përmbartuesi gjyqësor është përgjegjës për ankandin, në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në këtë udhëzim.

7. Modeli standard i shpalljes për shitjen në ankand, informacionit që shoqëron shpalljen dhe dokumenteve të tjera të ankandit përcaktohen nga Dhoma Kombëtare e Përmbartuese Gjyqësore Privatë me miratimin e Ministrit të Drejtësisë.

8. Çmimi fillestar në ankand është 80 për qind i çmimit të përcaktuar sipas nenit 564 të Kodit të Procedurës Civile.

III. ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Ofertuesit nënshkruajnë një deklaratë, përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me përmbartuesin gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Secili ofertues që merr pjesë në ankand nëpërmjet paraqitjes së ofertës, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci, në zyrën e përmbartimit, një shumë të hollash të barabartë me 10 për qind të çmimit të sendit të caktuar në shpallje.

Kreditoret nuk lë garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.

3. Përmbartuesi gjyqësor kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues, vetëm nëse:

a) jep ofertën dhe ankandin brenda afatit të përcaktuar në shpalljen për shitjen në ankand;

b) paraqet formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet e ankandit;

c) paraqet dokument identifikimi;

ç) kandidati ose ofertuesi është person juridik, paraqet, sipas rastit:

i) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

ii) certifikatën e regjistrimit në organet tatimore ose NIPT-in.

4. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim për ofertën ndërmjet përmbartuesit gjyqësor dhe ofertuesit. Përmbartuesi gjyqësor nuk ka të drejtë t'u kërkojë ofertuesve të ndërmarrin përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e ankandit, apo të ndryshojnë vlerën e ofertës ose ta modifikojnë në çfarëdo mënyre atë.

5. Shitja e sendit bëhet në zyrën e përmbartuesit gjyqësor ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit dhe që është njoftuar në shpalljen e shitjes në ankand. Ajo vazhdon 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të ditës së fundit që tregohet në shpalljen për shitjen në ankand.

6. Përmbartuesi gjyqësor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e ankandit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati.



Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga përmbartuesi gjyqësor, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistruhen në procesverbalin e procedurës së ankandit.

Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal, në të cilin ofertuesi shënon, kundrejt nënshkrimit, çmimin që jep për sendin, pavarësisht nga çmimi që ka dhënë më parë. Në rast se ofertuesi vepron me përfaqësues, duhet të paraqitet dhe të shënohet në procesverbal edhe prokura noteriale.

7. Pas përfundimit të seancës publike, përmbartuesi gjyqësor verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat ligjore. Nëse përmbartuesi gjyqësor gjykon se i nevojitet më shumë se një ditë pune për të përfunduar veprimtarinë e tij, vë në dijeni pjesëmarrësit për orën dhe datën kur ofertuesve do t'u komunikohet rezultati i vlerësimit të ofertës dhe kualifikimi përfundimtar. Kohëzgjatja e procedurës nuk duhet të kalojë 10 (dhjetë) ditë.

Përmbartuesi gjyqësor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Në çdo rast, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Megjithatë, përmbartuesi gjyqësor duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi, duke njoftuar menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

Përmbartuesi gjyqësor vlerëson se oferta është e vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në shpalljen për shitjen në ankand dhe në dokumentet e ankandit.

Përmbartuesi gjyqësor vlerëson se një ofertë është e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e ankandit, apo gabime të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Përmbartuesi gjyqësor nuk e pranon një ofertë kur:

- a) ofertuesi nuk është i kualifikuar;
- b) ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik;
- c) oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e ankandit;
- ç) në rastet e refuzimit apo të skualifikimit, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

8. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të ofertave, përmbartuesi gjyqësor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e ankandit. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit duhet të pranohet të paktën një ofertë e vlefshme.

Ofertat renditen duke filluar me çmimet më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes.

Përmbartuesi gjyqësor përcakton ofertën më të mirë, pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Përmbartuesi gjyqësor shpall fitues ofertuesin, oferta e të cilit përmbush kriteret kualifikuese dhe ka dhënë çmimin më të lartë.

Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit që ka paraqitur ofertën më të mirë, si dhe ofertuesve të tjerë të suksesshëm. Njoftimi i fituesit përmban:

- a) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij;
- b) emrat e ofertuesve pjesëmarrës dhe vlerat e ofertave të tyre;
- c) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.

Njoftimi i fituesit shpallet në një vend të dukshëm në zyrën e përmbartuesit gjyqësor.

9. Shitja e sendit në ankand është e pavlefshme nëse në procedurën e ankandit marrin pjesë si ofertues debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, përmbaruesi gjyqësor, si dhe personat e përcaktuar në nenin 709 të Kodit Civil, dhe që sipas nenit 572 të Kodit të Procedurës Civile, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.

Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga blerësi kalon në dobi të shtetit dhe sendi, me kërkesë të secilit kreditor, mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në këtë udhëzim.

10. Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, që zbritet me 20% nga çmimi i ankandit të parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e caktimit të çmimit të ri dhe u nënshtrohet të njëjtave rregulla si për ankandin e parë, të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në këtë udhëzim.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë vepohet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 577 të Kodit të Procedurës Civile.

IV. PËRFUNDIMI I PROCEDURËS SË ANKANDIT

1. Pas përcaktimit të ofertuesit fitues, përmbaruesi gjyqësor njofton menjëherë blerësin që të paguajë çmimin e sendit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga mbarimi i ankandit.

2. Me pagimin e çmimit dhe të taksës mbi aktet për shitjen e sendit, përmbaruesi gjyqësor jep vendim për kalimin e sendit në pronësi të blerësit, të cilin ia njofton blerësit.

3. Blerësi fiton të gjitha të drejtat që kishte mbi sendin debitori nga momenti i nxjerrjes së vendimit për kalimin e sendit në pronësi nga përmbaruesi, i cili është i detyruar të vërë në posedim të blerësit sendin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga pagimi i çmimit të sendit.

4. Blerësi, që nuk paguan çmimin brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, humbet të drejtën e kthimit të shumës së lënë si garanci, e cila kalon në dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, duke ndjekur rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në këtë udhëzim.

V. ANKIMIMI

Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera gjatë procedurës së ankandit, mund të bëhet ankim në gjykatë, në formën e kundërshtimit të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Banka e Shqipërisë, si dhe përmbaruesit gjyqësorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 15, datë 13.12.2012

PËR MATERIALET DHE ARTIKUJT NË KONTAKT ME USHQIMIN

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të sigurojë funksionimin efektiv të tregut të brendshëm në lidhje me nxjerrjen në treg të materialeve dhe artikujve të destinuar për të qenë në kontakt të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë me ushqimin, duke garantuar bazën për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorëve.



2. Ky udhëzim do të zbatohet për materialet dhe artikujt, duke përfshirë materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë në kontakt me ushqimin (më poshtë “materiale dhe artikuj”), të cilët:

a) janë në kontakt me ushqimin dhe janë të paracaktuar të jenë të tillë;

b) ka arsye të pritët të jenë në kontakt me ushqimin apo të transferojnë përbërësit e tyre në ushqim në kushte normale ose të parashikuar të përdorimit.

3. Ky udhëzim nuk zbatohet për:

a) materialet dhe artikujt që shërbejnë si antikë;

b) materialet mbështjellëse ose ambalazhuese, të tilla si: mbulesa e jashtme e djathit, produkteve të mishit ose të frutave të parapërgatitura etj., që përbëjnë pjesën e produkteve ushqimore dhe mund të konsumohen bashkë me to;

c) pajisjet e furnizimit me ujë.

4. Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, kanë të njëjtin kuptim, me përjashtim të përcaktimeve të “gjurmueshmërisë” dhe “vendosjes në treg”, të cilat do të kenë kuptimet e mëposhtme:

a) “gjurmueshmëria” është aftësia për të gjurmuar dhe për të ndjekur një material ose artikull gjatë të gjitha fazave të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes;

b) “vendosje në treg” është mbajtja e materialeve dhe artikujve për qëllim shitjeje, duke përfshirë ofertën për shitje ose ndonjë formë tjetër transferimi, me pagesë ose jo, si dhe shitjen, shpërndarjen dhe format e tjera të transferimit.

5. Gjithashtu, në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “materiale dhe artikuj aktivë në kontakt me ushqimin” (më poshtë materiale dhe artikuj aktivë) janë materialet dhe artikujt që kanë për qëllim të zgjatin jetëgjatësinë dhe të mbajnë ose të përmirësojnë gjendjen e ushqimit të pakëtuar. Ato janë projektuar qëllimisht që të bashkojnë komponentët që do të çlirohen ose të absorbojnë substancat në/ose nga ushqimet e pakëtuara apo mjedisi përreth ushqimit;

b) “materiale dhe artikujt inteligjentë në kontakt me ushqimin” (më poshtë materialet dhe artikujt inteligjentë) janë materialet dhe artikujt të cilat monitorojnë gjendjen e ushqimeve të pakëtuara apo mjedisin përreth ushqimit;

c) “biznes” nënkupton çdo ndërmarrje, me qëllim përfitimi ose jo, publike apo private, që kryen ndonjë nga aktivitetet e lidhura me çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së materialeve dhe artikujve;

d) “operatori i biznesit” nënkupton personat fizikë ose juridikë, përgjegjës, për të siguruar që kërkesat e këtij udhëzimi janë plotësuar në biznesin nën kontrollin e tyre.

6. Materialet dhe artikujt, duke përfshirë materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë, prodhohen në përputhje me praktikën e mira të prodhimit në mënyrë që, në kushte normale ose të parashikuara të përdorimit, ato nuk transferojnë përbërësit e tyre në ushqim në sasi që:

a) mund të rrezikojnë shëndetin e njerëzve;

b) mund të shkaktojnë një ndryshim të papranueshëm në përbërjen e ushqimit;

c) mund të shkaktojnë dëmtim të karakteristikave organoleptike të tyre.

Etiketimi, reklama dhe prezantimi i një materiali ose artikulli nuk duhet të orientojë në mënyrë të gabuar blerësin.

7. Materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë që janë në kontakt me ushqimin të etiketohen në mënyrë të përshtatshme për të lejuar identifikimin nga konsumatori të pjesëve jo të ngrënshme.

8. Materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë duhet të etiketohen në mënyrë të përshtatshme për të treguar se materialet ose artikujt janë aktivë dhe/ose inteligjentë.

9. Materialet dhe artikujt aktivë të mos shkaktojnë ndryshime në karakteristikat e përbërjes apo organoleptike të ushqimit, duke maskuar, për shembull, prishjen e ushqimit, që mund të mashtrorë konsumatorët.

10. Materialet dhe artikujt inteligjentë nuk japin informacion në lidhje me gjendjen e ushqimit që mund të çorientojnë konsumatorët.

11. Për grupet e materialeve dhe artikujve të listuar në shtojcën I dhe, kur është e përshtatshme, kombinimet e këtyre materialeve dhe artikujve ose materialeve dhe artikujve të ricikluar të përdorur në prodhimin e tyre, mund të ndërmerren masa të veçanta. Këto masa specifike mund të përfshijnë:

- a) listën e substancave të autorizuar për përdorim në prodhimin e materialeve dhe artikujve;
- b) listën e substancave të autorizuar të bashkuara në materialet dhe artikujt aktivë ose inteligjentë në kontakt me ushqimin, ose listën e materialeve dhe artikujve aktiv ose inteligjent dhe, kur është e nevojshme, kushtet e veçanta të përdorimit për këto substanca dhe/ose materialet dhe artikujt në të cilët ato janë të përfshira;
- c) standardet e pastërtisë për substancat e përmendura në germën “a”;
- d) kushtet e veçanta të përdorimit për substancat e përmendura në germën “a” dhe/ose materialet dhe artikujt në të cilat ato janë përdorur;
- e) kufijtë specifike të migrimit të përbërësve të caktuar ose grupeve të përbërësve në ushqim, duke marrë parasysh nga burime të tjera të mundshme zbulimin e këtyre përbërësve;
- f) një kufi të përgjithshëm të migrimit të përbërësve në ushqim;
- g) dispozitat që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve ndaj rreziqeve që vijnë nga kontakti me materialet dhe artikujt;
- h) rregulla të tjera për të siguruar pajtueshmërinë me pikën 6;
- i) rregullat bazë për të kontrolluar përputhshmërinë me germat “a” deri “h” të kësaj pike;
- j) rregullat në lidhje me marrjen e mostrave dhe metodat e analizave për të kontrolluar përputhshmërinë me germat “a” deri “h” të kësaj pike;
- k) dispozita specifike për të siguruar gjurmueshmërinë e materialeve dhe artikujve;
- l) dispozita shtesë për etiketimin e materialeve dhe artikujve aktivë dhe inteligjentë;

12. Prodhimi dhe përpunimi i materialeve dhe artikujve në kontakt me ushqimin do të bëhet duke përdorur substanca, të cilat janë të lejuara në vendet e Bashkimit Europian.

13. Pa cenuar dispozitat e dhëna në pikën 11, materialet dhe artikujt, të cilët nuk janë ende në kontakt me ushqimin kur vendosen në treg, do të shoqërohen nga:

- a) vendosja e fjalëve “Për kontakt me ushqimin” ose një tregues specifik të përdorimit të tyre, të tillë si: makinë kafeje, shishe vere, lugë supe ose simbolin e dhënë në shtojcën II;
- b) nëse është e nevojshme, udhëzime të veçanta që duhet të respektohen për të garantuar përdorimin e përshtatshëm dhe të sigurt të ushqimit;
- c) emri ose emri tregtar dhe, në secilin rast, adresa e regjistruar e prodhuesit, përpunuesit ose shitësit, përgjegjës për vendosjen në treg të materialit apo artikullit;
- d) etiketim i përshtatshëm ose dokumente identifikimi për të siguruar gjurmueshmërinë e materialit apo artikullit;
- e) në rastin e materialeve dhe artikujve aktivë, informacion mbi përdorimin ose përdorimet e lejuara dhe informacione të tjera, të tilla si: emri dhe sasia e substancave aktive të çliruara nga komponentët aktivë në mënyrë që të mundësojnë operatorët e biznesit ushqimor, që përdorin këto materiale dhe artikuj, të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë edhe atë të etiketimit të produkteve ushqimore.

14. Informacioni i kërkuar në pikën 13 germa “a” nuk është i detyrueshëm për ata artikuj, të cilët, për shkak të karakteristikave të tyre, kanë qëllim të qartë që do të jenë në kontakt me ushqimin.

15. Informacioni i kërkuar në pikën 13 të jetë i dukshëm, qartësisht i lexueshëm dhe të mos fshihet.

16. Materialet dhe artikujt do të tregtohen me pakicë, vetëm nëse informacioni i kërkuar në pikën 13 germat “a”, “b” dhe “d” është dhënë në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme nga blerësit.

17. Materialet dhe artikujt që tregtohen në tregun shqiptar duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe krahas gjuhëve të tjera.

18. Në fazën e shitjes me pakicë, informacioni i kërkuar në pikën 13 do të vendoset në:

- a) materialet dhe artikujt ose mbi paketimin e tyre;
- b) etiketa vendoset mbi materialet dhe artikujt ose mbi paketimin e tyre;



c) një njoftim në afërsi të materialeve dhe artikujve, i cili të jetë në mënyrë qartësisht të dukshme për blerësit; për informacionin e kërkuar në pikën 13 germa “c”, ky opsion duhet të aplikohet vetëm nëse, për arsye teknike, ky informacion ose një etiketë e ngjitur nuk mund të vendoset në materialet dhe artikujt gjatë fazës së prodhimit ose tregtimit.

19. Në fazat e tjera të tregtimit, të ndryshme nga ajo e shitjes me pakicë, informacioni i kërkuar në pikën 13 do të vendoset në:

- a) dokumentet shoqëruese;
- b) etiketë ose paketim;
- c) vetë materialet dhe artikujt.

20. Informacioni i dhënë për pikën 13 germat “a”, “b” dhe “d” duhet të kufizohet për materialet dhe artikujt që janë në përputhje me:

- a) kriteret e përcaktuara në pikën 6;
- b) masat specifike të dhëna në pikën 11.

21. Materialet dhe artikujt e mbuluara nga masat specifike të dhëna në pikën 11 të shoqërohen me një dokument ku deklarohet se ato janë në përputhje me rregullat e zbatueshme për to. Dokumentacioni duhet t’i vihet në dispozicion Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) me kërkesën e tyre.

22. Gjurmueshmëria e materialeve dhe artikujve të sigurohet në të gjitha fazat në mënyrë që të lehtësojnë kontrollin, tërheqjen nga tregu të produkteve të dëmtuara, informimin e konsumatorit dhe përcaktimin e përgjegjësive. Operatorët e biznesit të aplikojnë sisteme dhe procedura për të lejuar identifikimin e bizneseve nga të cilat janë furnizuar dhe kanë furnizuar dhe kur është e përshtatshme, masat zbatuese të përdorura në prodhimin e tyre. Ky informacion duhet t’i vihet në dispozicion AKU-së me kërkesën e saj.

23. Kur AKU-ja, si rezultat i një informacioni të ri ose të një rivlerësimi të informacionit ekzistues ka arsye për të dyshuar se përdorimi i një materiali ose artikulli, megjithëse plotëson kërkesat e këtij udhëzimi, përbën një risk për shëndetin e njerëzve, mund të pezullojë përkohësisht ose të kufizojë përkohësisht përdorimin e tij nga operatorët e biznesit ushqimor deri në momentin kur nuk ka më arsye të dyshojë.

24. Udhëzimi nr. 10, datë 4.9.2007 “Për materialet në kontakt me ushqimin”, shfuqizohet.

25. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

SHTOJCA I

LISTA E GRUPEVE TË MATERIALEVE DHE ARTIKUJVE QË MUND TË MBULOHEN ME MASA SPECIFIKE

1. Artikuj dhe materiale aktive dhe inteligjente;
2. Ngjitësit;
3. Qeramika;
4. Tapa;
5. Goma, kauçuk;
6. Xham;
7. Jon-shkëmbyes i resinave;
8. Metale dhe aliazhe;
9. Letër dhe dërrasë;
10. Plastika;

11. Bojëra shkrimi;
12. Celulozë e rigjeneruar;
13. Silikon;
14. Tekstile;
15. Llak dhe veshës;
16. Dyllë;
17. Dru.

SHTOJCA II



Simbol

UDHËZIM Nr. 18, datë 27.12.2012

PËR SASINË E MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR NË PAKETIME ORIGJINALE QË MUND TË IMPORTOHET PËR PËRDORIM VETJAK

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 25 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Bujqësore,

UDHËZOJ:

1. Sasia e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në paketime origjinale, që mund të importohet për përdorim vetjak, përcaktohet në aneksin 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi.
2. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor me paketim origjinal që mund të importohet për përdorim vetjak, duhet të jetë i etiketuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.
3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli



ANEKSI 1
SASITË E MATERIALIT MBJELLËS SIPAS SPECIEVE

| Nr. | Emri latinisht | Emri shqip | Për përdorim vetjak me paketim original (kg, fara dhe fidanë) |
|----------------------------|--|------------------------|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| I. Cerealet | | | |
| 1 | A vena sativa L. | Tërshëra | 5 kg |
| 2 | Hordeum vulgare L. | Elbi | 5 kg |
| 3 | Panicum miliaceum L. | Meli | 2 kg |
| 4 | Secale cereale L. | Thekra | 5 kg |
| 5 | Sorghum bicolor (L.) Moench | Melekuqja | 2 kg |
| 6 | Sorghum sudanense Stapf. | Sorgumi sudanez | 2 kg |
| 7 | X Triticum secale Wittm. | Tritikale | 5 kg |
| 8 | Triticum aestivum L. Emend. Fiori et Paol. | Gruri i butë | 5 kg |
| 9 | Triticum durum Desf. | Gruri i fortë | 10 kg |
| 10 | Triticum spelt a L. | Tepa | 5 kg |
| 11 | Zea mays L. (partim) | Misri | 2 kg |
| 12 | Oryza sativa L. | Orizi | 5 kg |
| II. Bimët foragjere | | | |
| II.A Barërat | | | |
| 1 | Agrostis sp. L. | Barimëza | 2 kg |
| 2 | Alopecurus pratensis L. | Bishtdhelpra livadhore | 2 kg |
| 3 | Bromus catharticus Vahl | Bromusi | 2 kg |
| 4 | Bromus sitchensis Trin. | Bromusi i Alaskës | 2 kg |
| 5 | Cynodon dactylon (L.) Pers. | Grami | 2 kg |
| 6 | Dactylis glomerata L. | Telishi | 2 kg |
| 7 | Festuca arundinacea Schreber | Festuka si kallam | 2 kg |
| 8 | Festuca ovina L. | Festuka e deleve | 2 kg |
| 9 | Festuca pratensis Hudson | Festuka livadhore | 2 kg |
| 10 | Festuca rubra L. | Festuka e kuqe | 2 kg |
| 11 | Lolium multiflorum Lam. | Lolium shumëlulesh | 2 kg |
| 12 | Lolium perenne L. | Lolium shumëvjeçar | 2 kg |
| 13 | Phleum pratense L. | Fleumi livadhore | 2 kg |
| 14 | Poa annua L. | Flokësi njëvjeçar | 2 kg |
| 15 | Poa nemoralis L. | Flokësi i pyjeve | 2 kg |
| 16 | Poa palustris L. | Flokësi i ligatinave | 2 kg |
| 17 | Poa pratensis L. | Flokësi livadhore | 2 kg |
| 18 | Poa trivialis L. | Flokësi i zakonshëm | 2 kg |
| 19 | Trisetum flavescens (L.) P. Beauv. | Triseta e zbehtë | 2 kg |

| | | | |
|-------------|--|----------------------|--------|
| II.B | Legominozet | | |
| 1 | Lotus corniculatus L. | Tërfili me brirë | 2 kg |
| 2 | Lupinus albus L. | Lupini i bardhë | 2 kg |
| 3 | Lupinus angustifolius L. | Lupini gjethengushtë | 2 kg |
| 4 | Lupinus luteus L. | Lupini i verdhë | 2 kg |
| 5 | Medicago lupulina L. | Jonxha lupulinë | 1 kg |
| 6 | Medicago sativa L. | Jonxha | 2 kg |
| 7 | Medicago x varia T. Martyn | Jonxha e ranishteve | 1 kg |
| 8 | Pisum sativum L. (partim) | Bizelja | 2 kg |
| 9 | Trifolium alexandrinum L. | Tërfili aleksandrin | 1 kg |
| 10 | Trifolium hybridum L. | Tërfili hibrid | 1 kg |
| 11 | Trifolium incarnatum L. | Tërfili i kuqërremtë | 1 kg |
| 12 | Trifolium pratense L. | Tërfili livadhor | 1 kg |
| 13 | Trifolium repens L. | Tërfili zvarritës | 1 kg |
| 14 | Trifolium resupinatum L. | Tërfili persian | 1 kg |
| 15 | Vicia faba L. (partim) | Batha | 3 kg |
| 16 | Vicia pannonica Crantz | Grashina panoneze | 3 kg |
| 17 | Vicia sativa L. | Koçkulla | 2 kg |
| 18 | Vicia villosa Roth. | Grashina | 2 kg |
| II.C | Bimë të tjera foragjere | | |
| 1 | Brassica napus L var. Napobrassica (L) Rchb. | Sinapi | 2 kg |
| 2 | Brassica oleracea L. convar. Acephala (DC.) | Lakra | 0.2 kg |
| 3 | Phacelia tanacetifolia Benth. | Këmbanorja blu | 02 kg |
| 4 | Raphanus sativus L. var. Oleiformis Pers. | Rrepa foragjere | 1 kg |
| III | Panxhari | | |
| 1 | Beta vulgaris L. ssp. vulgaris var alba, DC. | Panxhari | |
| IV | Duhani | | |
| 1 | Nicotiana tabacum L. | Duhani | 0.1 kg |
| V | Pambuku | | |
| 1 | Gossypium Hirsutum L. | Pambuku | 3 kg |
| VI | Bimët vajore dhe fibroze | | |
| 1 | Brassica napus L. (partim) | Sinapi | 1 kg |
| 2 | Brassica nigra (L.) Koch | Lakra e zezë | 1 kg |
| 3 | Brassica rapa L. var. (Lam.) Briggs | Kolza | 1 kg |
| 4 | Cannabis sativa L. | Kërpi | - |
| 5 | Glycine max (L.) Merill | Soja | 3 kg |
| 6 | Helianthus annuus L. | Luledielli | 2 kg |
| 7 | Linum usitatissimum L. | Lini | 2 kg |
| 8 | Arachis hypogea | Kikiriku | 2 kg |
| VII | Patatja | | |
| 1 | Solarium tuberosum L. | Patatja | 15 kg |



| VIII | Perimet | | |
|------|---|--------------------|---------|
| 1 | Allium cepa L. | Qepa | 0.3 kg |
| 2 | Allium porrum L. | Preshi | 0.3 kg |
| 3 | Allium sativum L. | Hudhra | 0.3 kg |
| 4 | Anthriscus cerefolium L. Hoffm. | Fier moskat | 0.05 kg |
| 5 | Apium graveolens L. | Selino | 0.02 kg |
| 6 | Asparagus officinalis I. | Asparagusi | 0.1 kg |
| 7 | Beta vulgaris L. var. vulgaris | Panxhar zakonshëm | 0.1 kg |
| 8 | Beta vulgaris L. var. conditiva Alef. | Panxhar i kuq | 0.1 kg |
| 9 | Brassica oleracea L. convar. acephala (DC) Alef. var. sabellica | Lakra kokë | 0.3 kg |
| 10 | Brassica oleracea L. convar. botrytis (L) Alef. var. botrytis L. | Lulelakra | 0.3 kg |
| 11 | Brassica oleracea L. convar. botrytis (L.) Alef. var. cymosa | Brokoli i hollë | 0.3 kg |
| 12 | Brassica oleracea L. convar. botrytis (L.) Alef. var. italica Plenck. | Brokoli kokë | 0.3 kg |
| 13 | Brassica oleracea L. convar. oleracea var. gemmifera DC | Lakra e Brukselit | 0.3 kg |
| 14 | Brassica oleracea L. Convar capitata (L) Alef. var. subauda L. | Lakra e Savojës | 0.3 kg |
| 15 | Brassica oleracea L. convar. capitata (L.) Alef. var alba DC | Lakra kokëbardhë | 0.3 kg |
| 16 | Brassica oleracea L. convar. capitata (L.) Alef. var rubra DC | Lakra kokëkuqe | 0.3 kg |
| 17 | Brassica oleracea L. convar. acephala (DC) Alef. var. gongylodes | Kolrabi | 0.3 kg |
| 18 | Brassica pekinensis (Lour.) Rupr. | Lakra kineze | 0.3 kg |
| 19 | Brassica rapa L. var. rapa | Rilka | 0.3 kg |
| 20 | Capsicum annuum L. | Speci | 0.04 kg |
| 21 | Cichorium endivia L. | Endivia | 0.02 kg |
| 22 | Cichorium intybus L. (partim) | Çikorja | 0.02 kg |
| 23 | Citrullus lanatus (Thunb.) Matsum. et Nakai | Shalqiri | 0.3 kg |
| 24 | Cucumis melo L. | Pjepri | 0.2 kg |
| 25 | Cucumis sativus L. | Trangulli | 0.03 kg |
| 26 | Cucurbita maxima L. | Kungulli i ëmbël | 0.3 kg |
| 27 | Cucurbit a pepo L. | Kungulli zakonshëm | 0.3 kg |
| 28 | Cucurbita pepo L. var. Styriaca Greb | Kungulli i verdhë | 0.3 kg |
| 29 | Daucus carota L. | Karota | 0.1 kg |
| 30 | Foeniculum vulgare Miller. | Finoku | 0.02 kg |
| 31 | Hybiscus esculentum | Bamja | 0.5 kg |
| 32 | Lactuca sativa L. | Sallata | 0.01 kg |
| 33 | Lycopersicon lycopersicum (L.) Karsten ex Farë. | Domatja | 0.01 kg |
| 34 | Petroselinum crispum (Miller) Nyman ex A.ë.Hill | Majdanozi | 0.01 kg |
| 35 | Phaseolus coccineus L. | Barbunja | 3 kg |

| | | | |
|-----------|---|-----------------------|------------|
| 36 | <i>Phaseolus vulgaris</i> L. | Fasulja | 3 kg |
| 37 | <i>Pisum sativum</i> L. (fnartim) | Bizelja | 2 kg |
| 38 | <i>Raphanus sativus</i> L. | Rrepa | 0.2 kg |
| 39 | <i>Solarium melongena</i> L. | Patëllxhani | 0.05 kg |
| 40 | <i>Spinacia oleracea</i> L. | Spinaqi | 0.1 kg |
| 41 | <i>Valerianella locusta</i> (L) Laterr. | Valeriana | 0.02 kg |
| 42 | <i>Vicia faba</i> L. (partim) | Batha | 4 kg |
| 43 | <i>Zea mays</i> L. (partim) | Misri i ëmbël | 5 kg |
| IX | Hardhia | | |
| 1 | <i>Vitis</i> spp. | Hardhia | 100 fidanë |
| X | Sumullbari (Humulusi) | | |
| 1 | <i>Humulus lupulus</i> L. | Sumullbari (Humulusi) | 50 fidanë |
| XI | Bimët drufrutore | | |
| 1 | <i>Castanea sativa</i> Mill. | Gështenja | 10 fidanë |
| 2 | <i>Citrus limon</i> (L.) Burm. f. lemon | Limoni | 10 fidanë |
| 3 | <i>Citrus reticulata</i> Blanco | Mandarina | 10 fidanë |
| 4 | <i>Citrus sinensis</i> (L.) Pers. | Portokalli | 10 fidanë |
| 5 | <i>Citrus x paradisi</i> Macfad. | Grapefruiti | 10 fidanë |
| 6 | <i>Citrus medica</i> | Qitro | 10 fidanë |
| 7 | <i>Citrus aurantifolia</i> (Christm.) Sëing | Nerënxa | 10 fidanë |
| 8 | <i>Cydonia</i> spp. | Ftoi | 10 fidanë |
| 9 | <i>Cornus mas</i> L. | Thana | 10 fidanë |
| 10 | <i>Corylus avellana</i> L. | Lajthia | 10 fidanë |
| 11 | <i>Diospyros kaki</i> L. | Hurma (kaka) | 10 fidanë |
| 12 | <i>Fragaria x ananassa</i> Duch. | Luleshtrydhja | 10 fidanë |
| 13 | <i>Ficus carica</i> | Fiku | 10 fidanë |
| 14 | <i>Zizyphus Zizyphus</i> | Hidja (xinxifja) | 10 fidanë |
| 15 | <i>Juglans regia</i> L. | Arra | 10 fidanë |
| 16 | <i>Actinidia</i> sp. | Kivi (aktinidia) | 10 fidanë |
| 17 | <i>Malus</i> Mill. | Molla | 10 fidanë |
| 18 | <i>Morus</i> sp. | Mani | 10 fidanë |
| 19 | <i>Mespilus germanica</i> | Mushmolla dimërore | 10 fidanë |
| 20 | <i>Eriobotrya japonica</i> | Nespola | 10 fidanë |
| 21 | <i>Olea europaea</i> L. | Ulliri | 10 fidanë |
| 22 | <i>Poncirus trifoliata</i> | Trifoljata | 10 fidanë |
| 23 | <i>Pistacia verra</i> L. | Pistaku | 10 fidanë |
| 24 | <i>Prunus amygdalus</i> Batsch | Bajamja | 10 fidanë |
| 25 | <i>Prunus armeniaca</i> L. | Kajsia | 10 fidanë |
| 26 | <i>Prunus avium</i> L. | Qershia | 10 fidanë |
| 27 | <i>Prunus cerasus</i> L. | Vishnja | 10 fidanë |
| 28 | <i>Prunus domestica</i> L. | Kumbulla gjatore | 10 fidanë |
| 29 | <i>Prunus persica</i> (L.) Batsch | Pjeshka | 10 fidanë |



| | | | |
|------------|-------------------------|-------------------|-----------|
| 30 | Prunus salicina Lindl. | Kumbulla japoneze | 10 fidanë |
| 31 | Pyrus communis L. | Dardha | 10 fidanë |
| 32 | Punica granatum | Shega | 10 fidanë |
| 33 | Ribes spp. | Ribes (Kulumbria) | 10 fidanë |
| 34 | Rubus spp. | Mjedra | 10 fidanë |
| 35 | Vaccinium L. | Boronica | 10 fidanë |
| XII | Bimët medicinale | | |
| 1 | Salvia Officinalis | Sherebela | 0.5 kg |
| 2 | Thymus Vulgaris | Timus | 0.2 kg |
| 3 | Lavandula officinalis | Lavanda | 0.2 kg |
| 4 | Origanum Vulgaris | Rigoni | 0.2 kg |

Shënim. Pavarësisht nga numri i varieteteve të një specije që importohen në paketime origjinale për përdorim vetjak, sasia maksimale duhet të jetë në përputhje me kolonën 4 të këtij aneksi.

URDHËR

Nr. 348, datë 14.12.2012

PËR MIRATIMIN E PROGRAMEVE MBIKËQYRËSE, ÇRRËNJOSËSE DHE STATUSIT “I LIRË NGA SËMUNDJET”, TË ZONAVE KU RRITEN KAFSHËT UJORE DHE NDARJEVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 95 të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare” dhe pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 25.7.2012 “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2012 – 2015 dhe përcaktimin e përgjegjësisë institucionale për përafrimin në legjislacionin shqiptar të çdo akti të legjislacionit të Bashkimit Europian”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Bujqësore,

URDHËROJ:

1. Miratimi i programeve mbikëqyrëse, çrrënjosësh, si dhe dhënia e statusit “I lirë nga sëmundjet”, për zonat dhe ndarjet territoriale në Republikën e Shqipërisë ku rriten kafshët ujore, bëhet sipas kritereve të mëposhtme.

1.1 Programet e mbikëqyrjes paraqiten për miratim pranë autoritetit kompetent nga drejtoritë rajonale të bujqësisë, siç parashikohet në nenin 44 të rregullores “Mbi kërkesat shëndetësore të kafshëve të akuakulturës dhe produkteve të tyre, parandalimin dhe kontrollin e disa sëmundjeve në kafshët ujore”, miratuar me urdhrin nr. 3, datë 18.1.2011, nëse ato mbulojnë:

- a) të gjithë territorin e vendit;
- b) zona ose ndarje të tyre, të përbëra nga më shumë se 75% e zonës bregdetare të vendit, për sa u përket vetëm sëmundjeve të cilat prekin specie të ujërave të kripura;
- c) zona dhe ndarje apo grupe të tyre, të përbëra nga më shumë se 75% të zonës kontinentale të vendit, për sa u përket vetëm sëmundjeve të cilat prekin specie të ujërave të ëmbla;
- d) zona dhe ndarje, apo grupe të tyre, të përbëra nga më shumë se 75% e sipërfaqes kontinentale dhe zonave bregdetare të vendit, për sa u përket sëmundjeve që prekin, si specie të ujërave të ëmbla, ashtu dhe ato të ujërave të kripura;

e) zona dhe ndarje të cilat përbëhen nga zona ujëmbledhëse të ujit, të përbashkëta me një vend tjetër.

